



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1676/ 6 prot

Datë 25.08.2025

V E N D I M
Nr. 1109/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nëkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.08.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
Adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruksion” SHPK me NIPT L91323019S, J68007522L dhe L31626006F me adresë: Rruga “Kodra e Diellit”, Ndërtesa Nr.2, Hyrja 15, Ap.11, Farkë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.04.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 26.05.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 18.06.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- BOE “Albpoëer Energy” SHPK & “Albavia” SHPK	18,417,879.08 lekë	skualifikuar
1- “HTM” SHPK	19,588,447.30 lekë	kualifikuar
2- BOE “Vega Solar” SHPK & “Vega Energy” SHPK	20,124,858.52 lekë	skualifikuar
3- BOE “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK	20,506,264 lekë	skualifikuar
4- BOE “EPES Group” SHPK & Encoal” SHPK	21,328,673.60 lekë	skualifikuar
5- “BE-IS” SHPK	21,442,494 lekë	kualifikuar
6- “Enercom” SHPK	21,689,459.84 lekë	skualifikuar
7- BOE “Sings & Road Safety Solutions” SHPK & “Alko Impex Construction” SHPK	22,396,85.10 lekë	skualifikuar
8- “Solar Energy Solutions” SHPK	23,781,378.96 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 18.06.2025 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

Operatori ekonomik BOE “Eidon-Grup” sh.p.k. Nipt: L91323019S & “NIGMA KONSTRUKSJON” sh.p.k. Nipt: L31626006F & “Junik” sh.p.k. Nipt: J68007522L me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë:

- OE “NIGMA KONSTRUKSJON” ka paraqitur si staf teknik një inxhinier elektrik , por sipas ndarjes së përcaktuar në marrëveshje pasi O.E duhet të kishte 66.75% të gjith stafit teknik përderisa nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e bashkëpunimit sic përcaktohet në nenin 88 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Nuk plotëson pikën 2.3.7 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet : “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet objekt prokurimi shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qarte specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit të distributorit duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit

te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor”.

- OE “Eidon-Grup” ka paraqitur autorizim distributori për matës elektrik , por në ndarjen e realizuar në ofertë pjesa e matësve elektrikë do kryhet nga OE “Junik” , i cili nuk ka asnjë autorizim nga distributorë apo prodhues për këtë pajisje. Për pajisjen inverter asnjë nga operatorët pjesëmarrës pjesë e BOE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 24.06.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 26.06.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/5482 dhe me nr. 1676/2025 prot, datë 26.06.2026, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Dielllore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK me pretendimet si vijon:

Autoriteti prokurues pretendon se: OE Nigma Konstruksjon ka paraqitur si staf teknik nje inxhinier elektrik, por sipas ndarjes se percaktuar ne marreveshje pasi O.E duhet te kishte 66.75% te gjith stafit teknik perderisa nuk eshte percaktuar ndryshe ne kontraten e bashkepunimit sic percaktohet ne nenin 88 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik. Ky pretendim nuk qendron pasi nese i referohemi kontrates se bashkpunimit te ngarkuar ne sistem eshte e cituar shprehimisht iPalet kanë shprehur interesin për t’ bashkuar forcat, mjetet, kompetencat dhe për t’ ndare përgjegjesite për arritjen e objektit t’ kësaj kontrate bazuar ne kete paragraf palet ne kete bashkpunim kane shprehur vullnetin qe te bashkojne stafin,mjetet,ekspertizen ne permbushje te kesaj kontrate. Ne asnje pike te VKM nuk eshte e shprehur qe palet pjesmarrese detyrimisht duhet qe te kene staf apo mjete qe te plotesohet ne perputhje me % e marre si bashkim operatoresh.

Ndaj sa siper Autoriteti Prokurues eshte tendencion dhe argumentimi nuk eshte i bazuar.

Autoriteti prokurues pretendon se: - Nuk ploteson piken 2.3.7 te seksionit 2.3 te Kapacitetit Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ku thuhet: Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi,ose marreveshje bashkepuni mi me prodhuesin, ose autorizim distributori per pajisjet objekt prokurimi shoqeruar me certificate/deklarate konfirmimit CE,

katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve ose skeda teknike te prodhuesit/ve,ku te dallohen qarte specifikimet teknike te saj. Ne rastin e autorizimit te distributorit duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail,   bbsite ne rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor OE Eidon-Grup ka paraqitur autorizim distributori per mates elektrik,por ne ndarjen e realizuar ne oferte pjesa e matesave elektrike do kryhet nga OE Junik, i cili nuk ka asnje autorizim nga distributore apo prodhues per kete pajisje. Ky pretendim nuk qendron pasi nese i referohemi elementit Mates elektrik ai eshte nje paisje dhe si e tille vetem furnizohet. Jo domosdoshmerisht duhet te jesh dhe furnizues dhe montues i kesaj paisje e cila nuk eshte e specifikuar ne asnje pike te DST ku Ai qe ka Autorizim/Distributim duhet te jete me pajteter dhe Montues.

Ndaj sa siper Autoriteti Prokurues eshte tendencion dhe argumentimi nuk eshte i bazuar.

Autoriteti prokurues pretendon se: - Per pajisjen inverter asnje nga operatoret pjesemarres pjese e BOE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Ky pretendim nuk qendron pasi nese i referohemi dokumentave te ngarkuar ne sistem gjendet file me emrtimin “Sungro _Certificate_Distributor_(1)” ku ka te detajuar te gjitha elemente e nevojshem sipas DST dhe me Distributor te Autorizuar Nigma Konstruksjon .Bashkengjitur ekstrakt me foto nga Sistemi.

Ndaj sa siper Autoriteti Prokurues eshte tendencion dhe argumentimi nuk eshte i bazuar.

II.7. N   p  rputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” t   Ligjit nr.162/2020 “P  r Prokurimin Publik”, me marrjen e ankes  s, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi at   n   baz  n e t   dh  nave t   tij, e cila p  rmban t   dh  na p  r: a) ankimuesin, adres  n dhe NUIS-in; b) t   dh  na t   plota p  r procedur  n e prokurimit (objekt, num  r reference, fond limit, dat  n e zhvillimit t   procedur  s), si dhe me an   t   formularit t   publikimit nr. 1676/1 prot., dat   27.06.2025 jan   publikuar arsyet e skualifikimit q   bashkimi i operator  ve ekonomik   ankimues “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK kund  rshton me an   t   ankes  s me nr. 1676 prot, dat   26.06.2025.

II.8. Me shkres  n nr. 1325/8 prot, dat   03.07.2025, protokolluar me ton  n me nr. 1676/2 prot dat   04.07.2025 (ardhur n  p  rmjet   sh  rbimit postar), me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankes  s s   paraqitur nga operatori ekonomik “Eidon Grup” SHPK, lidhur me vler  simin n   procedur  n e prokurimit me nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt Instalim Panele Diellore”, autoriteti kontraktor ka d  rguar pran   Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit t   ankes  s nr. 63/2025 prot, dat   03.07.2025 t   operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimii t   cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankes  s me argumentimin si vijon:

N   nenin 109 “E drejta e ankimimit” te ligjit nr. 162/2020 “P  r Prokurimin Publik” parashikohet:

- 1.   do operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes t   ligish  m n   n  j procedure prokurimi sipas LPP dhe kur shte d  mtuar ose rrezikohet t   d  mtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, p  r te cilat pretendon se jan   ne*

kundershtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

- 2. Pas shayrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimimit në Gjykatën Administrative të Apelit, ne perputhje me nenin 121 të këtij ligji, si dhe në perputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fugi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

Në nenin 94 “Paraqitja e ankesave” të VKM nr. 285/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

- 1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është demtuar ose rrezikohet të dimtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 2. Operatori ekonomik ankimues dergon njekohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.*
- 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, qe permban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencen e procedures konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimuesi do të paraqesë në autoritetin entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.*
- 4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të siperpermendura ose nuk është shoqeruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi behet në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftoje Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mesipërme, për korrigjimin e te metave të ankesës.*
- 5. Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet ne autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) diteve nga njoftimi. Shtuar me VKM 498/2024, Ndryshuar me VKM 498/2024, Ndryshuar me VKM 498/2024, Ndryshuar me VKM 498/2024. Nese ankesa nuk korrigjohet/plotesohet brenda këtij afati, ajo vleresohet si e paparaqitur. Nese afati i fundit bie gjate diteve të pushimit zyrtar, atëhere afati i fundit per plotesimin e ankesës do te jete ditën pasardhese te punes.*

6. *Formulari standard i ankeses hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.*

Lidhur me pretendimet e Operatorit Ekonomik ankimues “Eidon-Grup” shpk mbi arsyet e s’kualifikimit të ofertes se tij, KSHA arsyeton se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim në teresi ankesën, konstaton se operatori ekonomik ankimues parashtron pretendime vetëm për s’kualifikimin e tij dhe nuk parashtron asnjë pretendim për operatorin ekonomik të shpallur fitues paraprak, duke mos mbështetur dhe ligjeruar në këte mënyrë interesin e tij konkret për kundërtë fitim të kontratës, objekt ankimimi.

Se pari, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton faktin se procedura e prokurimit është procedure “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, lloji “Marreveshje Kuader me afat 36 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, pra qartazi derivon fakti që fituesi do të jetë vetëm një, cka nuk e legjitimon mungesën e paraqitjes së pretendimeve për këte të fundit, me një vlerë më të ulët të ofertes ekonomike, në rastin e paraqitjes së ankesave për këte procedure prokurimi.

Se dyti, konstatohet se operatori ekonomik, i shpallur fitues paraprak ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë 19,588,447.30 leke pa tvsh, statusi i kualifikuar, ndërsa bashkimi i operatoreve ekonomike “Eidon-Grup” shpk & “Nigma Konstruksjon” shpk & “Junik” shpk, një ofertë ekonomike me vlerë 20,506,264 leke pa tvsh, statusi, i s’kualifikuar. Pra, operatori ekonomik ankimues nuk paraqet interes të ligjshëm për vijimin e kësaj anese pasi kundërshton vetëm vendimin lidhur me skualifikimin e tij, pa ngritur asje pretendim lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik fitues. Vlen të theksohet se oferta e operatorit ekonomik fitues është me vlerë më të ulët se ajo e vetë operatorit ekonomik ankimues, ka do të thotë se edhe nëse ankesa e tij do të pranohet dhe ky i fundit do të kualifikohet, nuk do të kishte anje ndikim në rezultatin përfundimtar të procedurës së prokurimit, pra nuk do të ishte ofertues i shpallur fitues.

Sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe jurisprudencës së Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me praktiken e vendimmarrjes, interesi i ligjshëm ekziston vetëm nëse pranimi i ankesës mund të sjellë ndryshim të statusit juridik të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me rezultatin përfundimtar të procesit të prokurimit për këte procedure. Në këte rast, mungon një lidhje shkak-pasoje ndërmjet pretendimeve të parashtruara dhe mundësive reale për të fituar kontratën, pasi edhe në hipotezën e kualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit do të klasifikohet dhe renditet pas ofertës ekonomike me të ulët, të fituesit aktual.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konsideron faktin që operatori ekonomik ankimues nuk ka një perspektivë reale lidhur me këte kontratë, çka impakton interesin e tij të ligjshëm për vijimin e kësaj anese, pasi i vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhenë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ankimuesi të fitojë kontratën.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me skualifikimin e tij nuk do të merren në shqyrtim.

Për Këto Arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

- 1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Eidon-Grup” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.*

II.9. Me shkresën nr. 2511 prot, datë 11.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1676/3 prot, datë 12.08.2025 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshejtimin e shqyrtimit të ankesës.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “OE Nigma Konstruksjon ka paraqitur si staf teknik një inxhinier elektrik, por sipas ndarjes së përcaktuar në marrëveshje pasi O.E duhet të kishte 66.75% të gjithë stafit teknik përderisa nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e bashkëpunimit sic përcaktohet në nenin 88 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapacitetin teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Staf Teknik	Numri
Elektricitist	2
Specialistë për instalime të paneleve diellore	3
Shofer	1

2.3.5/1 Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi,

(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshje bashkëpunimi Nr. 2533 Rep dhe Nr. 1389 Kol, datë 26.05.2025 ndërmjet shoqërive “Junik” SHPK & “Eidon Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK, ku në nenin 4 “Pjesëmarrja” përcaktohet se: “pjesëmarrja e shoqërive të shprehur në përqindje në arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jetë si më poshtë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Eidon Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit”;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Junik” SHPK;

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Eidon Grup” SHPK;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një

organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

II.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet

ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. PP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër BOE ankimes ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Junik” SHPK, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Edion Grup” SHPK dhe të operatorit ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 26.05.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Junik” SHPK, shoqërisë “Edion Grup” SHPK dhe shoqërisë “Nigma Konstruksjon” SHPK përkatësisht në nenin 4 “Pjesëmarrja” rezulton, se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Edion Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen

nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 26.05.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Junik” SHPK dhe shoqërisë “Edion Grup” SHPK dhe shoqërisë “Nigma Konstruksjon” SHPK përkatësisht në nenin 4 “Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës rezulton, se do të jetë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Edion Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit. Akoma më tej, referuar listës së çmimeve sipas zërave të preventivit rezulton, se zërat si *F.V. Automat magneto-termik 380V,63A, 4P, 2.54I, F.V Module fotovoltaike 540wp AnPV00, F.V Inverter 100 kw AnPV002, F.V Inverter 80 kw AnPV003, F.V Inverter 40 kw AnPV004, F.V Inverter 30 kw AnPV005*, do të realizohen nga operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni B: Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate” deklaron se disponon 29 punonjës mesatarisht për periudhën 3 muajt e fundit, gjithashtu deklaron se disponon personelin kryesorë të poshtëshënuar: z. LL. B, me profesion inxhinier elektrik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik, inxhinier elektrik. Ndërkohë referuar marrëveshjes së bashkëpunimit datë 26.05.2025 operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon”, SHPK ka si pjesëmarrje në zbatimin e kontratës 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit akoma më tej referuar zërave të preventivit sipas punimeve që do të kryejë operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK rezulton se do të kryejë punime si *F.V. Automat magneto-termik 380V,63A, 4P, 2.54I, F.V Module fotovoltaike 540 wp AnPV00, F.V Inverter 100 kw AnPV002, F.V Inverter 80 kw AnPV003, F.V Inverter 40 kw AnPV004, F.V Inverter 30 kw AnPV005*, për të cilat nevojitet punonjësi elektrikist dhe specialistë për instalime të paneleve diellore të cili nuk janë deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Sa më sipër arsyetuar BOE nuk e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit sipas profilit të tyre.

Sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se: “Nuk plotëson pikën 2.3.7 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet objekt prokurimi shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te saj. Ne rastin e autorizimit te distributorit duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor” OE “Edion-Grup” ka paraqitur autorizim distributori për matës elektrik, por në ndarjen e realizuar në ofertë pjesa e matësve elektrikë do kryhet nga OE “Junik”, i cili nuk ka asnjë autorizim nga distributorë apo prodhues për këtë pajisje. Për pajisjen inverter asnjë nga operatorët pjesëmarrës pjesë e BOE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.7, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet objekt prokurimi shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te saj. Ne rastin e autorizimit te distributorit duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Ëeb, E-mail, Nr. kontakti
1	Module fotovoltaike 540Ëp		
2	Inverter		
3	Mates Verifikues		

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar është paraqitur dokumentacioni si vijon:

- Marrëveshje bashkëpunimi Nr. 2533 Rep dhe Nr. 1389 Kol, datë 26.05.2025 ndërmjet shoqërive “Junik” SHPK & “Eidon Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK, ku në nenin 4 “Pjesëmarrja” përcaktohet se: “pjesëmarrja e shoqërive e shprehur në përqindje në arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jetë si më poshtë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Eidon Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit”;
- Dokumentin “Autorizim Distributori”, i lëshuar më datë 23.05.2025, me përmbajtje: “Kompania Electric System Albania shpk me NUIS L41306091 M me adresë në Vaqarr Tiranë, është distributor i kompanisë Prodhuese Baylan, sipas deklaratës bashkangjitur, për materialet Matës Energjie Elektrike Tip BTK-40 (Import Eksport). Autorizojmë Edion Grup me NIPT L91323019S, të dorëzojë ofertën dhe të garantojë furnizimin për produktet e sipërcituara të prodhuara nga kompania Baylan për tenderin Instalim Panele Diellore. Bashkalidhur ndodhet edhe autorizimi i kompanisë prodhuese Baylan Olçu Aletleri San.Ve Tic. Ltd, i datës 21.11.2023, lëshuar për kompaninë Electric System Albania. [...]”;
- Dokumentin “Letter of Authorization”, i vlefshëm deri më 29.05.2027, me përmbajtje: “Smart Gunes Enerjisi Teknoloji;eri Arge Uretim Sanayi ve Ticarer A. S, an internationally recognized nd reputable manufacturer of PV modules ëith production facilities in Turkiye, hereby confirms that Nigma Konsruksjon shpk 9VAT L31626006F), located at Bulevardi Nënë Tereza, Bathore, Kamëz, Albania is authorized to sell Smart Solar Branded PV modules ëithin the territory of Albania [...]”;
- Dokumentin “Authorized Distributor”, me përmbajtje: “This is to Certify That Nigma Konstruksjon Albania is the authorized distributor and services partner of Sungroë Poëer Supply Co. Ltd. Validity from January 1, 2023 [...]”;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.6. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e

çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.2.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. PP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i

parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër BOE ankimues ka dorëzuar dokumentacion e cituar në pikën III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 26.05.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Junik” SHPK, shoqërisë “Edion Grup” SHPK dhe shoqërisë “Nigma Konstruksjon” SHPK përkatësisht në nenin 4 “Pjesëmarrja” rezulton, se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Edion Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjetur, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 26.05.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Junik” SHPK dhe shoqërisë “Edion Grup” SHPK dhe shoqërisë “Nigma Konstruksjon” SHPK përkatësisht në nenin 4 “Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës” rezulton, se do të jetë: “Junik” SHPK 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Edion Grup” SHPK 14.30 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, “Nigma Konstruksjon” SHPK 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit. Akoma më tej, referuar listës së çmimeve sipas zërave të preventivit rezulton, se zërat si *F.V Struktura Alumini per montimin e paneleve AnPV006*, *F.V Shkarkues mbitensioni DC AnPV007*, *F.V Shkarkues mbitensioni AC AnPV008*, *F.V Kabell Solar 4mm2 AnPV009*, *F.V Connector DC MC4 + AnPV010*, *F.V Connector DC MC4 - AnPV011*, *F.V. Mates Verifikues AnPV012*, *F.V. Mates me dy drejtime per TU AnPV013*, *F.V Transformatore Rryme 150/5A per TU AnPV014*, *F.V Transformatore Rryme 100/5A per TU AnPV015*, *F.V Automat magneto-termik 380V,200A, 4P AnPV016*, do të realizohen nga operatori ekonomik “Junik” SHPK, ndërkohë që autorizim pordhuesi për Matës Verifikues sipas kërkesës në pikën 2.3.7 është paraqitur nga anëtarin BOE “Edion Grup” SHPK, ndërsa zërat *F.V. Automat magneto-termik 380V,63A, 4P, 2.541*, *F.V Module fotovoltaike 540wp AnPV00*, *F.V Inverter 100 kw AnPV002*, *F.V Inverter 80 kw AnPV003*, *F.V Inverter 40 kw*

AnPV004, *F.V Inverter 30 kw AnPV005*, do të realizohen nga operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK, për të cilën ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania Smart Solar Technologies, dhe autorizim distributori nga kompania Sungrow Power Supply. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik “Junik” SHPK referuar marrëveshjes se bashkëpunimit datë 26.05.2025 ka si pjesëmarrje në zbatimin e kontratës 18.95 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit, referuar listës së çmimeve sipas zërave të preventivit rezulton, se zërat si *F.V Struktura Alumini per montimin e paneleve AnPV006, F.V Shkarkues mbitensioni DC AnPV007, F.V Shkarkues mbitensioni AC AnPV008, F.V Kabell Solar 4mm2 AnPV009, F.V Connector DC MC4 + AnPV010, F.V Connector DC MC4 - AnPV011, F.V. Mates Verifikues AnPV012, F.V. Mates me dy drejtime per TU AnPV013, F.V Transformatore Rryme 150/5A per TU AnPV014, F.V Transformatore Rryme 100/5A per TU AnPV015, F.V Automat magneto-termik 380V,200A, 4P AnPV016*, zëra në të cilat përfshihet edhe Matësi Verifikues është marrë përsipër nga ky operator ekonomik, referuar parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së 285, operatori “Junik” SHPK kishte detyrim për të paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për Matësat Verifikues, përsa kohë që në zërat e preventivit ky shërbim është marrë nëpërsipër për tu realizuar nga ky operator ekonomik. Ndërsa operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon”, SHPK ka si pjesëmarrje në zbatimin e kontratës 66.75 % duke marrë përsipër të realizojë punimet të parashikuara për këtë kontratë me specifikimet teknike përkatëse sipas ndarjes së përqindjeve/preventivit ku referuar zërave të preventivit sipas punimeve që do të kryejë operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK rezulton se do të kryejë punime si *F.V. Automat magneto-termik 380V,63A, 4P, 2.541, F.V Module fotovoltaike 540wp AnPV00, F.V Inverter 100 kw AnPV002, F.V Inverter 80 kw AnPV003, F.V Inverter 40 kw AnPV004, F.V Inverter 30 kw AnPV005*, në përmbushje të kriterit 2.3.7 operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK referuar dhe zërave të marrë përsipër në preventiv ka dorëzuar dokumentin “Letter of Authorization”, i vlefshëm deri më 29.05.2027, me përmbajtje: “Smart Gunes Enerjisi Teknoloji;eri Arge Uretim Sanayi ve Ticarer A. S, an internationally recognized nd reputable manufacturer of PV modules ëith production facilities in Turkiye, hereby confirms that Nigma Konsruksjon shpk 9VAT L31626006F), located at Bulevardi Nënë Tereza, Bathore, Kamëz, Albania is authorized to sell Smart Solar Branded PV modules ëithin the territory of Albania [...]”; dhe dokumentin “Authorized Distributor”, me përmbajtje: “This is to Certify That Nigma Konstruksjon Albania is the authorized distributor and services partner of Sungrow Power Supply Co. Ltd. Validity from January 1, 2023 [...], dokument nëpërmjetë të cilit arrinë të përmbushi kriterin 2.3.7, referuar zërave të marrë përsipër në preventiv zëra në të cilat përfshihen edhe Modulet Fotovoltaike 540 wp dhe Inverter. Nisur nga aryeja e skualifikimit, Komisioni gjykon se, në

këto kushte anëtar i BOE “Junik” SHPK nuk arrinë të vërtetojë përmbushjen e kriterit 2.3.7, pasi nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi apo autorizim distributori për zërin Matës Verifikues, zë i cili referuar preventivit është marrë përsipër për tu realizuar nga ky operator ekonomik. Ndërsa në lidhje me zërat Module fotovoltaike 540 wp dhe Inverter, të cilat referuar preventivit janë marrë përsipër për tu realizuar nga operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK, nga ky i fundit është paraqitur dokumentacion i kërkuar në pikën 2.3.7, duke përmbushur këtë kriter kualifikues. Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Nigma Konstruksjon” SHPK referuar zërave të marrë përsipër në preventiv ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

